

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Nazmije Ibrahimimi dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit C. për R. e K. (CRK), me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson A. Q., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës B. B., me seli në Prishtinë, për fitim të pabazë në shumën e përgjithshme prej 641.504 €, përkitazi me revizionin e të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.105/2014, datë 9.10.2015, në seancën e mbajtur më 4.2.2016, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.105/2014, datë 9.10.2015.

Aktgjykimi i cituar **ndryshohet** përkitazi me kamatën, kështu që detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë shumën e aprovuar me kamatë sipas normës së depozitave të paafatizuara të kursimit, të cilat i paguajnë bankat afariste në Kosovë, pa destinim të caktuar, mbi një vit, duke filluar nga data 10.8.2013 (data e ekspertizës), deri te pagesa definitive.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ae.nr.105/2014 datë 9.10.2015, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Çështje Ekonomike, C.nr.413/2012 datë 11.3.2014, me pjesën I të dispozitivit të të cilit është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit. Me pjesën II të dispozitivit është detyruar e paditura që shumën e përgjithshme prej 641.504 € t'ia paguajë palës paditëse në emër të fitimit të pabazë nga shfrytëzimi i hapësirave të kompleksit ..., prej datës 2.7.2011 deri në datën 15.3.2011, me kamatë ligjore prej 3.5%, llogaritur nga data e paraqitjes së padisë deri te pagesa definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, duke llogaritur nga data kur aktgjykimi merr formë të prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit me detyrim. Me pjesën III të dispozitivit është vendosur që shpenzimet e procedurës kontestimore t'i heqë secila palë veç e veç.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura ka paraqitur me kohë revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të ndryshohen aktgjykimet e gjykatave të

instancave më të ulëta, ashtu që kërkesëpadia e paditësit të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe të detyrohet paditësi t'i paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore.

Paditësi ka paraqitur përgjigje ndaj revizionit, me propozimin që ky të refuzohet si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, konstatoi:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi, më datë 2.7.2001 ka lidhur me UNMIK-un kontratë koncesioni për një periudhë 10-vjeçare, sipas së cilës UNMIK-u i jepte paditësit me koncesion hapësirat e N.SH. "...” në Podujevë. Me kontratën nr. ... datë ..., paditësi dhe e paditura lidhin kontratë për menaxhimin e kompleksit ish- "...”, me pikën 4 të së cilës është parashikuar që ajo lidhet për periudhën sa zgjatë kontrata e koncesionit, përkatësisht deri në datën 2.7.2011, ndërsa me pikën 5 (obligimet e dhënësit) është parashikuar që CRK-ja nuk do ta ketë të drejtën e pjesëmarrjes në fitimin e krijuar gjatë tërë periudhës menaxhuese dhe, pas përfundimit të kontratës, grupi investues i CRK-ës nuk mban obligime kredituese ndaj BPB-ës. Me aneks-kontratën nr... datë ..., Bordi i drejtorëve të AKP-ës (si pasardhëse e UNMIK-ut), ka aprovuar kërkesën e CRK-ës për zgjatjen e afatit të shfrytëzimit të hapësirave të përcaktuara me kontratën bazë deri më 30.6.2012. E paditura ka vazhduar shfrytëzimin e hapësirave të ish- kompleksit "...” edhe pas skadimit të afatit, përkatësisht nga data 2.7.2011 deri më 15.3.2012, me pretendimin se në datën 14.3.2011 me paditësin kishin lidhur aneks-kontratën për vazhdimin e kontratës së koncesionit të datës 2.7.2001.

Paditësi ka kërkuar me padi që e paditura të obligohet t'ia paguajë shumën prej 641.504 €, në emër të fitimit të pabazë, për shkak të shfrytëzimit të hapësirave të kompleksit "...” prej datës 2.7.2011 deri më 15.3.2012.

Gjykata e shkallës së parë ka gjetur pas administrimit të provave se aneks-kontrata e datës 14.3.2011 është nënshkruar nga personi i paautorizuar, ndërsa shumën prej 641.504 € në emër të fitimit të humbur, lidhur me shfrytëzimin e hapësirave të kompleksit "...”, e ka aprovuar në bazë të konstatimit të ekspertit R. B., pastaj ka vendosur si në dispozitiv të atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar në procedurën ankimore, e ka aprovuar si të drejtë e të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me miratimin e kërkesëpadiës, meqë nga aneks-kontrata e datës 14.3.2011 për menaxhimin e kompleksit të ish- "...” nuk rezulton që të jetë bërë vazhdimi i afatit të kontratës kryesore, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancave më të ulëta, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike,

kanë zbatuar drejt të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpapia e paditësit është e bazuar. Aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështjeje juridike, të cilat janë të pranueshme edhe për këtë Gjykatë, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi i theksuar në revizion se aktgjykimet e të dy shkallëve të gjykatave janë marrë me shkelje thelbësore të dispozitave ligjore të parashikuara nga neni 182 par. 1 të LPK, ngase nuk janë zbatuar neni 322 par. 2 dhe neni 329 i Ligjit të përmendur më lart, Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi si të pabazuar, ngase faktin nëse S.B. ka pasur apo jo autorizim për të nënshkruar aneks-kontratën gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga dëshmitarët e dëgjuar në seancën kryesore më datë 19.4.2013, të cilët kanë pohuar se S. B., në kohën kur e ka nënshkruar aneks-kontratën ka qenë vetëm anëtar i Bordit, ndërsa nuk ka prezantuar asnjë provë që të ketë qenë i autorizuar nga kryetari dhe anëtarët e tjerë për ndërmarrjen e një veprimi të tillë. S.B., si nënshkruer i aneks-kontratës nuk ka poseduar autorizim për përfaqësim të interesave të të gjithë aksionarëve të paditësit – C.

E paditura pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është marrë me shkelje thelbësore të parashikuara nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK, sepse arsyetimi nuk përmban kriteret e parashikuara nga neni 160 par. 4 të LPK, por Gjykata Supreme e Kosovës vlerësoi se një pretendim i tillë është i pabazuar, ngase në arsyetimin e aktgjykimit të goditur janë përfshirë të gjitha faktet relevante për një aktgjykim të drejtë e të ligjshëm.

Gjykata e Apelit e Kosovës, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka ekzaminuar në përputhje me dispozitën ligjore të nenit 194 të LPK. Ajo i ka vlerësuar pretendimet e paraqitura në ankesë lidhur me shkeljet thelbësore, duke konstatuar se ato janë të pabazuara, sepse aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje thelbësore të parashikuara nga neni 182 par. 1 e 2 pika (n) e LPK. Gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar se thëniet e tjera ankimore të të paditurës kanë qenë objekt shqyrtimi në gjykatën e shkallës së parë, ndërsa nuk janë vënë në dukje arsye konkrete me të cilat do të mund të sillej në dyshim rregullsia dhe ligjshmëria e aktgjykimit të goditur.

Pretendimet e cekura në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara, sepse gjykatat e të dy shkallëve kanë zbatuar drejt dispozitën e nenit 210 të LMD, nen ky që parashikon rregullat e përgjithshme të fitimit të pabazë.

Gjykata Supreme e Kosovës ka gjetur se gjykata e shkallës së dytë ka vlerësuar drejt se z. B. nuk ka pasur autorizim për nënshkrimin e aneks-kontratës (nga aksionarët e tjerë të CRK-së) dhe aneks-kontrata është e paqartë, (në aneks-kontratë nuk mund të konstatohet se për cilën periudhë kohore është fjala, ndërsa qëndron konstatimi se nuk ndryshojnë raportet përkatësisht kushtet e palëve kontraktuese); prej saj nuk mund të kuptohet nëse është fjala për vazhdim të

kontratës dhe për cilën periudhë kohore vlen vazhdimi, prandaj edhe sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aprovimi i kërkesëpadisë së paditësit për shumën prej 641.504 € është i drejtë dhe i bazuar në ligj, shumë kjo është vërtetuar në bazë të ekspertizës së ekspertit R. B., i cili e ka hartuar atë në bazë të dokumentacionit të prezantuar nga palët ndërgjyqëse.

Gjykata Supreme e Kosovës i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të revizionit rreth kontratës bazë, kohëzgjatjes së saj, marrëveshjes për shlyerjen e borxhit, fakteve që kanë të bëjnë me nënshkrimin e aneks-kontratës, autorizimit për nënshkrim, borxhit pa mbulesë, por konstatoi se të gjitha këto kanë qenë objekt shqyrtimi para gjykatave të instancave më të ulëta dhe kanë të bëjnë me vërtetimin e gjendjes faktike, mbi të cilën bazë, sipas nenit 214 par. 2 të LPK, nuk mund të shqyrtohen me revizion.

Lidhur me caktimin e kamatës, aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta janë marrë me zbatim të gabuar të së drejtës materiale, gjë që çoi në ndryshimin e tyre, ashtu që paditësit shuma e përgjithshme e aprovuar në dispozitiv të aktgjykimit, në emër të fitimit të humbur, duhet t'i paguhet me kamatë sipas normës që paguhet për depozitar e kursimeve të paafatizuara të cilën e paguajnë bankat afariste në Kosovë pa destinim të caktuar, mbi një vit, duke filluar nga data 10.8.2013, (data e ekspertizës), deri në pagesën definitive.

Nga sa u tha më lart dhe me zbatimin e nenit 222 dhe nenit 224 par. 2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË
E.Rev.nr.3/2016 datë 4.2.2016

Kryetare e kolegjit,
Emine Kaçiku